

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

1. Diplomë universitare “Master i shkencave” në UPT;
2. Diplomë e sistemit të vjetër 5-vjeçar në UPT;
3. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoratës ose në rregulloren e saj.
4. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DNP) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 5-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80 % e pikëve totale.
6. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SAUPT, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
7. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.